



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-26878//20
Kaçanik, 30.10.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX-të (Nëntë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 30 Tetor 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë-të gjithë. .

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, 7 drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj, Fatmir Loku dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi dhe Arbnora Kuka.

Nga OJQ (KDI), mbledhjen e monitoroj, Kijani Sallahu.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët. Kuorumi ekziston, prezentë në mbledhje janë të gjithë anëtarët, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IX-të (Nëntë) të Rregullt për vitin 2020, data 30 Tetor 2020, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020;
3. Informatë e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020;
4. Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 60/01-504/18 të datës 28.02.2018 -për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A.- Njësia në Kaçanik.;
5. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së KK për vitin 2021; dhe
6. Shqyrtimi i Vendimit 01Nr.060/01-18351/20 i datës 12.08.2020-Për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës, sipas Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Financave.

Ju njoftoj së pika 2, Raporti financiar për periudhën Janar-Shtator 2020 është hequr nga rendi i punës në mbledhjen e KPF dhe i njëjti hiqet edhe në këtë mbledhje, për shkak së materiali është dërguar me vonesë.

Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Vërejtje në Procesverbal paraqitën:

z. Hajredin Luta, Në f. 6 të diskutimi im janë bërë tre gabime teknike, të shuma e projektit është “5500 €” e jo 550€. Të pasuesi Bunjakëve duhet të jetë “Mulakve” dhe të pasuesi Osmanëve duhet të jetë “Zmakve”.

z. Ekrem Raka, Në f. 5 të diskutimi i im ku e kam potencuar buxheti fillestar të vitit 2020, është bërë një gabim teknik, ashtu që shifrës së buxhetit i mungojnë tre zero (0).

Kryesuesi i Kuvendit, Me këto gabime teknike, Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VIII (Tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 29 Shtator 2020/ Lënda: 01Nr. 060/01-23473//20.

Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të komunës i korrigjuar.

Pyetje dhe Kërkesa

z. Shemsedin Luzha, Desha me bërë një Deklarim se tash e tutje unë i bashkohemi grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

znj. Albana Troni, Gjithashtu edhe unë Deklaroj së i bashkohem subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

Kam një Kërkesë për DAK, për paralelet parashkollore; A mendoni se i keni furnizuar me mjete pune, me libra janë furnizuar, mirëpo gjithmonë kur kanë nevojë për ndonjë gjë tjetër qoftë edhe për ndonjë letër, edukatorët detyrohen me komunikuar me prindër për me shtuar mjete me u furnizuar me atë material.

Kryesuesi i Kuvendit, Përpos këtij deklarimi zyrtar me gojë, është mirë të bëni një deklarim me shkrim Zyrës së KK.

z. Ekrem Kyçyku, Së pari i uroj mirëseardhje Shemsedin dhe Albanës në subjektin politik të LVV, iu uroj suksese. Unë i kam dy pyetje;

1. Nuk jam i kënaqur me përgjigjen e DSHPE lidhur me përgjigjen në pyetjen të cilën e kam ngritur në mbledhjen e kaluar të KK. Pyetja ime ka qenë; Operatori a e ka kaluar afatin në projektin shtrimin me kubza në qytet, nëse po, a është paditur ?

2. Të shëtitorja rreth lumit Neredime, shtyllat kanë qenë të betonit, shtyllat janë këputur, ndërkaq ka mbetur armatura e cila paraqet rrezik për qytetarë. Kërkoj të merren veprime të nevojshme për heqjen e betonit ku kanë qenë të vendosura shtyllat.

3. E dimë që malet u shkatërruan me të madhe sidomos Lyboteni tani është livadh që shihet nga këtu, por edhe malet tjera, me çka kemi dështuar në mbrojtjen e pyjeve. Ajo që është me keq është së të "Qeshma e Boshnjakëve" ka qenë një lis 100 vjeçar i cili ishte prerë. Po ashtu edhe të "Teqja", ka qenë një lis shumë i madh, edhe ai lis është prerë. A është në dijeni drejtori i DBPZHR për prerjen e këtyre dy lisave ?

znj. Rabije Sallahi, Përshëndetje për të gjithë, i nderuari kryesues, Sa i përket KPF, në këtë komitet nga AAK ka qenë kolegia ime Albana.

1. Unë e kam një kërkesë që ky komitet të zëvendësohet dhe kjo pozitë i takon AAK, duke u bazuar në UA Nr.03/2024 -Për procedurën e themelimit dhe përbërjen e KPF në komunë. Unë këtë kërkesë e parashtroj në bazë të nenit 6 pika 1 ku përbërja e KPF duhet t'i takoj subjektit të AAK. Neni 13 pika 3.5 thotë; Kur anëtari kalon në ndonjë etnitet tjetër politik, zëvendësohet me anëtarin tjetër të njëjtit subjekt politik të cilën i ka takuar anëtari në rastin e zgjedhjes.

Kërkoj që zëvendësimi i KPF të bëhet në mbledhjen vijuese të KK dhe kjo pozitë t'i kaloj AAK, pasi që anëtarja nga AAK ka kaluar në subjekt tjetër politik. Kërkoj që kërkesa ime të merret parasysh, në të kundërtën i drejtohem organeve përgjegjëse.

2. Pyetje për DSHPE, Cilat janë emërtimet e rrugëve të reja, a u formua komisioni për këtë çështje, administratorët e fshatrave i kanë dërguar kërkesat e tyre, por ende nuk kanë marrë përgjigje. A është formuar komisioni dhe pse nuk janë bërë ende emërtimet e rrugëve të reja.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkesa tuaj znj. Rabije për zëvendësim të anëtarit në KPF është mirë të dërgoni me shkrim në Zyrën e KK. Ne mundemi për kërkesën tuaj të kërkojmë sqarim edhe në MAPL.

znj. Vlora Dalloshi, Përshëndetje për të gjithë, E kam një kërkesë për drejtorin e DAK lidhur me listën përfituese të bursave që janë shpërndarë në këtë vit. E di që për vitin vijues ka ende kohë, por të merren parasysh që në listën përfituese të bursave të përfshihen edhe studentët që studiojnë në Universitetin e Tetovës.

z. Adnan Reka, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Edhe pas njoftimit me shkrim, dua t'ju njoftoj se nga data 15.10.2020 unë kam dhënë dorëheqje të pakthyeshme nga Komisioni për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë, për arsye të shpërfilljes së Konkursit Publik.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë e kam marrë njoftimin, nuk ka pasur ndonjë propozim për zëvendësim, besoj se komisioni mundet me qenë funksional. Meqë për secilin rast duhet të bëhet komision i ri, jemi në fund kur ky komision duhet vendosur për çështjen e dhënies në shfrytëzim të pronës, kështu që nuk di sa ka arsye të zëvendësohet ky komision.

z. Adnan Reka, Mundet me u shqyrtuar çështja e ligjshmërisë së këtij komisioni, sepse me 4 anëtarë, ky komision mund të jetë jo funksional. A mundet kjo kërkesë me u dërguar në shqyrtim ligjor së a është funksional ky komision me 4 anëtarë.

Kryesuesi i Kuvendit, Nuk po hyjnë në çështjen e ligjshmërisë, por një çështje e di së, të gjitha komisionet funksionojnë kur kanë kuorum, sepse mund të ndodhë që për çështje të

arsyeshme të mungoj një anëtar i komisionit, apo dorëheqjes, ndërsa komisioni të funksionoj. Çka ndodhë para vendim-marrjes nga një anëtarë të jap dorëheqje, atëherë kur kryhet vendimmarrja në atë komision. Kërkesën tënde mundesh me dërguar në shqyrtim ligjor, ti mundesh vet si anëtar i komisionit dhe anëtar i subjektit politik. Për me pasur me të qartë, ju drejtoni vet MAPL, mundemi me bërë shkresën së bashku, ata munden me ta kthyer një përgjigje e ti mos me u pajtuar, kështu që e adresoni ju vet kërkesën tuaj në MAPL.

z. Selim Reka, E kam një kërkesë për DAK; Pasi jemi në prag të ndarjes së bursave për studentë të komunës, me qenë kriter që ata nxënës të cilët nuk e kanë kryer shkollën e mesme në Kaçanik –për drejtime që ekzistojnë, mos me përfutur bursë, sepse nxënësit po na ikin në shkollat e komunave tjera dhe kjo po ndikon në zvogëlimin e numrit të nxënësve në shkollat tona.

z. Bekim Koxha, Përshëndetje për të gjithë, Selimi e potencoj një kriter për ndarjen e bursave, ndërkaq unë jam mos të futet ky kriter, për shkak së nuk do të thotë vetëm drejtimi, por nxënësit mund të shkojnë në shkollat e komunave të tjera edhe për shkak të cilësisë në arsim.

Kryesuesi i Kuvendit, Jemi të pyetje dhe Kërkesat, mos të hyjmë në replikë të kërkesave të njëri tjetrit, nëse keni kërkesa me iu drejtuar ekzekutivit të komunës urdhëroni, ndërkaq çështja që u ngrit si problem për nxënësit që shkojnë me mësuar në shkolla të tjera, kur të hynë si propozim, atëherë mundemi me debatuar.

z. Shemsedin Luzha, Desha të bëhem lokalist në f. Begracë. Është një fushë e madhe në Begracë, ne e quajmë fushë e madhe së komuna e ka shpallë zonë industriale apo ekonomike nuk e di saktë. Aty kanë filluar do lëvizje, flitet që varrezat e fshatit Begracë të mblidhen të tëra në një pikë. Lagjja që është aty afër, po dëmtohet me realizimin e këtij projekti Kërkesa e komunitetit është me shikuar hapësira të tjera për këtë çështje.

z. Besim Vishi, Sa për informim pasi drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani është prezent në mbledhje, e kam fjalën për ndriçimin publik në f. Dubravë, afër 50 % e dritave janë në defekt Ndoshta ato rregullohen, por mua me ka bërë përshtypje se kjo është bërë dukuri e zakonshme, investimet po bëhen, po shpenzohen mjetet, ndërkaq po ndodhin defektet menjëherë. Nuk po dua me shfrytëzuar rastin tani për çështjen e kanalit të ujitjes, me patën thirrur si komision, shkuam, lagjja kishte bërë ankesë, dhe me ka ardhur marre që ende pa hyrë në punë kanali, ka pasur prishje. Shpenzimet po bëhen, ndërkaq kualiteti po mungon në realizimin e projekteve.

znj. Lirije Luta, Përshëndetje për të gjithë, e kam një pyetje për drejtorin e arsimit, për shkak së është shqetësim nga prindërit dhe nga disa nxënës për mbylljen e shkollave. Desha me pyetur konkret a ka ndonjë informatë konkrete nga ministria e arsimit së a do të mbyllet shkollat krejt apo vetëm në ato shkolla ku ka virus.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkesa të tjera nuk ka, atëherë kalojmë në shqyrtimin e pikave vijuese të rendit të punës;

2. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë këtu, para së me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi- drejtor i DEFZH, Të nderuar anëtarë të KK, ashtu si jeni në dijeni, komuna e ka një obligim ligjor ndaj kontratës kolektive në arsim. Pika e rendit të punës ndërlihet me një pikë me herët që kemi debatuar lidhur me rezervat e pagave për procedurën përbarimore për kompensimin e arsimtarëve sipas kontratës kolektive, iu falënderojmë për përkrahjen që na i keni dhënë. Deri me tani është kryer një pjesë e madhe e obligimeve, jemi të angazhuar pasi jemi në fund të vitit t'i kryejmë obligimet ligjore, pasi që çdo vonesë na dërgon në procedurë përbarimore. Tani i kemi hulumtuar mjetet e lira të cilat janë tepricë, që ato mjete pa rrezikuar asnjë projekt t'i orientojmë në mallra dhe shërbime në kryerjen e obligimeve të arsimit ndaj kontratës kolektive. Në vazhdim drejtori i sqaroi të gjitha mjetet që transferohen sipas këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Kjo është një çështje të cilën edhe me herët e kemi përfunduar në shumicën e shkollave pa i dëmtuar projektet kapitale. Tani na ka mbetur edhe një pjesë e vogël të disa punëtorëve arsimor që nuk e kanë gëzuar atë të drejtë dhe iu ka takuar dhe kjo është mirë që me këto ndryshime po kryhen pagesat pa u dëmtuar asnjë projekt dhe ne si grup i LDK e përkrahim.

z. Ekrem Kyçyku, Lidhur me këtë vendim, ne edhe në mbledhjen e kaluar e kemi dhënë mendimin tonë. Kjo është si pasojë e kontratës kolektive në ministrinë e arsimit dhe të vendimit gjyqësor. Ne do të abstenojmë kur të votohet kjo çështje, duke pasur parasysh së me këtë po iu bëhet e padrejtë punëtorëve tjerë që punojnë në sektorin publik.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte, Shumica votuan Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 11 Anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020 / Lënda: 01Nr. 400/01-26309/20.

3. Informatë e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori është prezentë këtu, sigurisht gjatë diskutimit do të kyçet, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Faleminderit kryesues, Në këtë informatë është paraqitur gjendja e shkollave në vitin e kaluar e cila nuk ka qenë e mirë për shkak të Covid-19 e cila na ka zënë në befasi të gjithëve, si punëtorëve arsimor dhe nxënësve, por pasi kishin kaluar dy periudha e kishim pak me lehtë edhe me përmbyllur vitin me ato njohuri që kishim ne dhe nxënësit, dhe në njëfarë forme secili ka arritur me realizuar atë minimumin e kërkuar. Nga ana e nxënësve vërtetë ka pasur nxënës që nuk ka pasur mundësi me u kyçur në mësim online për shkak të kushteve teknike apo pamundësisë me u kyçur. Viti ka përfunduar, shpresojmë që ky vit të mbyllet mirë, pasi që jemi pak më të përgatitur se kemi mbajtur një trajnim edhe stafi mësimdhënës me stafin e informatikës. Në rast së ndodhë ndonjë rast e infektimit, mund të mbyllen shkolla për dy javë ditë, por jo në tërësi, sepse asgjë nuk e zëvendëson mësimin në formë fizike. Kishte me qenë mirë të përgatiten më mirë shkollat me pajisje teknologjike, që nëse ndodhë me kaluar në mësim online, me u realizuar mësimi nga shkollat. Shqetësuese është numri i madh i mungesave të nxënësve dhe arsimtarët, edhe pse disa mungesa janë të arsyeshme.

z. Ekrem Kyçyku, E dimë se ka qenë i vështirë fillimi i vitit të ri shkollor, për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19. Pyetjet e mia për drejtorin e DAK në KPF kanë qenë: Sa është realizuar mësimi online, A ka pasur nxënës që nuk kanë pasur mundësi me u kyçur në mësim online për shkak të kushteve teknike ? dhe A kanë mundur me u kyçur në mësim online nxënësit me nevoja të veçanta ? Unë kam marrë përgjigje, por dëshiroj të njoftohen të gjithë këtu me përgjigjen e drejtorit të DAK. Mungesat janë të mëdha, rezultati është jo real, në një shkollë mesatarja është 4,75% që del së të gjithë nxënësit e asaj shkolle kanë qenë të shkëlqyeshëm.

z. Adnan Reka, Faleminderit, Vitin e kaluar ju keni thënë se keni paraparë blerjen e disa laptopëve dhe projektorëve për sistemin arsimor të komunës, bile në fund të vitit 2019 edhe suficitin buxhetor ju u munduat ta arsyetoni përmes këtyre laptopëve, duke thënë se operatori ka sjell laptop me performanca më të dobëta nga çfarë ju kishit kërkuar, dhe ju si “të përgjegjshëm” që jeni ua keni kthyer prapa.

Por jo, e vërteta ishte se ju kishit kërkuar 143 laptop, 36 projektorë dhe 2 kompjuterë vetëm për 50,427,00 €, gjë që është e pa mundur edhe sikur t'i kishit blerë direkt nga prodhuesi. Ju kishit nënshkruar kontratën më 19.12.2018 dhe afatin e liferimit (dërgesës) e kishit vetëm 10 ditë, që i bien vetëm 5 ditë pune kur kemi parasysh edhe festat në këtë periudhë, dhe ju “nuk e dinit” se një kërkesë e tillë kërkon së paku një muaj, sepse nuk ka kompani në Kosovë që në stoqet e veta mban 143 laptop dhe 36 projektorë, dhe në fund fare ju lidhni një kontratë me një shtypshkronjë, dhe më pas, ju e ndërprisni kontratën se kinse kompania nuk ua ka sjell 143 laptop, 36 projektorë dhe 2 kompjuterë me performancat e kërkuara, vetëm për 50,427 €.

Ju lutem, mos mashtroni sepse mashtrimi që ju po bëni nuk është as menaxhim, as politikë, e as moral! Jemi në një vit pandemie, kompjuterizimi i shkollave është shumë i nevojshëm, veproni së paku për këto që ju vet keni deklaruar.

z. Agim Mani, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Sa i përket drejtorit të DAK për vitin shkollor 2019/2020, gjendja është shqetësuese në komunën tonë. Shqetësuese është rënia e numrit të nxënësve dhe një indikacion për këtë rënie është migrimi i qytetarëve të komunës të cilët i kanë humbur shpresat për të jetuar dhe vepruar këtu. Ky trend po vazhdon sikurse në kohën e okupimit. Ky trend i migracionit ka ndikuar që të zvogëlohet numri i nxënësve në shkolla. Shqetësim tjetër është, numri i madh i mungesave të nxënësve, kjo mund të ndikojnë edhe në arritjen e sukseseve të nxënësve si komponentë e rëndësishme. Numri i mungesave të nxënësve 35928 të shprehur për 8.18 orë të humbura të nxënësve dhe numrin e orëve të humbura të arsimtarëve prej 1391 orë të humbura, të shprehur në 8.33 orë të humbura, duke pasur parasysh edhe periudhën e shkurtër të mësimi, po të kishte vazhduar mësimi në objekte shkollore deri në muajin qershor ashtu si është e paraparë, këto mungesa do të ishin më të mëdha edhe orët e humbura të arsimtarëve do të ishin edhe më të mëdha. Kam një pyetje për drejtorin e DAK, pasi kjo drejtori është organ përgjegjëse për menaxhimin e arsimit për funksionimin dhe mbarëvajtjen e arsimit. A ka ndonjë kriter për funksionimin e rrjeteve shkollore të ndara në paralele dhe a mund të ndryshohet varësisht nga numri i nxënësve të cilët mund të variojnë nëpër shkolla. P.sh. SHM e ulët “Emin Duraku” me 5 paralele, me një numër të madh të nxënësve dhe shkolla e mesme e ulët “Naim Frashëri” në Kotlinë me një numër të shumë të vogël të nxënësve, e që të kanë drejtor shkolle. Për me pasur një shkollë drejtor shkolle, a shkon në proporcion me numrin e nxënësve që ka shkolla.

z. Ekrem Raka, Faleminderit kryesues, ky raport paraqet gjendjen jashtëzakonisht të rëndë të arsimit në këtë komunë, për mua janë përgjegjës ata që kanë menaxhuar arsimin deri tani. Ajo që me ra në sy në këtë raport është, për vitin shkollor 2019/2020 në dy shkollat e mesme janë regjistruar 214 nxënës me pak sesa viti paraprak, e që i bien 7 paralele më pak. Nëse ky trend

vazhdon, atëherë mund të vjen puna me i mbyllur dy shkollat e mesme në mungesë të nxënësve. Unë mendoj së është momenti i fundit për reforma të thella në arsim, me depolitizuar arsimin e me ua kthyer profesionistëve, përndryshe gjendja në arsim është shumë e rëndë.

z. Bekim Koxha, Unë jo rastësisht e thash së cilësia e arsimit po shihet, me çka nxënësit po shkojnë me studiuar në komunat tjera, si Ferizaj etj. me pasur cilësi, nuk shkojnë nxënësit me studiuar në shkollat e komunave tjera.

z. Selim Reka, Unë mendoj se Gjinnazi mund të llogaritet për cilësi me e mira për drejtimet që i ka. Këtë e ka vërtetuar edhe testi i maturës për përqindjen e arritur. Arsyeja pse shkojnë nxënësit në shkolla tjera është se, disa e kanë më afër fjala vjen Ferizajn, përndryshe Ferizaj kur po vijne këtu po e shohin se çfarë rregulli ka këtu.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë mendoj se është e padrejtë me iu drejtuar drejtorisë dhe menaxhmentit dhe me akuzuar për rënien e numrit të nxënësve në shkolla, sepse është një trend në tërë Kosovës. Në rënien e numrit të nxënësve ndikojnë shumë faktorë, si shpërngulja e madhe e nxënësve për me gjetur mundësi me të madhe në vende me të zhvilluara. Arsimi është një fushë e gjerë, ka shumë mundësi edhe për kritika sepse ke të bësh me numër të madh të stafit, nxënësve dhe objekteve dhe kjo është më e vështirë për me u menaxhuar, edhe pse disa nga kritikantët janë të arsyeshme, por me iu drejtuar kritikantët për zvogëlimin e numrit të nxënësve, unë kujtoj se nuk është e arsyeshme. Besoj së shqetësimet e juaja i ka marrë drejtori, andaj ia jap fjalën drejtorit të DAK, Zahir Doda.

z. Zahir Doda-drejtor i DAK, Mirëdita, përshëndetje; Po e filloj me fjalinë, Me vjen mirë që jeni të shqetësuar dhe si shoqëri të shqetësohemi për çështjen e arsimit. Me vjen mirë që askush nuk tha se kam dhënë një informatë të kamufluar, por informata është reale. Shqetësimi është evident, edhe unë jam i shqetësuar, për gjendjen në arsim. Këto janë ato pikat që pajtohem edhe unë, ndërkaq për pjesën e pyetjeve, po mundohem me u përgjigjur. Të pyetja shqetësimin që e potencoj Lirije Luta se a kanë më u mbyll shkollat, po jap tani përgjigjen së nuk pret për mbledhjen vijuese. Nuk ka asnjë informatë zyrtare. Nëse në një shkollë janë 5-8 % e nxënësve të infektuar me Covid, atëherë mbyllet shkolla për dy javë. Këto kritere janë të përcaktuara, ndërkaq deri sot nuk ka të infektuar në shkolla. Shpresoj të mos ndodhë e më u mbyllur shkollat. Diku 10 % e nxënësve nuk kanë pasur mundësi me u kyçur online, as përmes TV nuk kanë pasur mundësi me e përcjellë edhe pse është dhënë mësimin online edhe përmes TV. Kemi qenë të papërgatitur me iu krijuar kushte me i përcjellë mësimin online. Fëmijët me nevoja të veçanta, ata në atë kohë kanë qenë në shtëpi dhe janë trajtuar njësoj, ndërkaq ndonjë informatë të saktë nuk kam. Të pjesa e komenteve në arsim, Selimi është në arsim dhe nuk kam çka të shtoj më tepër, janë të gjitha të vërteta edhe sukcesi i Gjinnazit, edhe numri i madh i mungesave, kjo është gjendja reale. Të çështja tjetër që nuk lidhet shumë më informatën, janë të vërteta thëniet që janë dhënë për kompjuterët për shkak të kualitetit. Unë të ofroj argumente dhe mundem me u marrë nëse kjo lëndë shkon edhe në hetime. E vërteta është kështu; Pse nuk është bërë në qershor, mjetet që i lëshon qeveria e Kosovës për komuna në fund të vitit. Ka qenë në muajin nëntor, afatet ligjore për tenderim janë shfrytëzua si afate të rregullta. Në momentin kur na i ka lëshuar mjetet qeveria, është lëshuar një shumë prej 300.000€. Me shkathtësinë me të madhe jemi munduar me i shfrytëzuar në maksimum. Çmimin e cakton oferta, dhe ai ka sjellë shkartë, dhe unë kam këmbëngulë mos me u pranuar ata laptop. Komisioni ka qenë shumë korrekt, së ato përformanca nuk janë si në tender. Për pjesën tjetër, ka ndodhur ajo, mjetet janë kthyer në qeveri dhe asgjë të keqe nuk ka pasur. Kam tentuar me

çdo kusht me furnizuar arsimin me laptop e pajisje tjera, por kjo ka ndodhë. Sikur se edhe sot, unë nuk kam të drejtë me intervenuar me tenderin. Të çështja e Agimit, është e vërtetë, po nuk kemi kritere se ku duhet me pasur drejtor ku jo, as kur me i mbyllur shkollat. Unë jam marrë më muaj për Llanishtë dhe Sllatinë për me i bindë prindërit me i pru fëmijët në shkollë, për mos me na ndodhur si në Kamenicë, që më dështuar e mos me humbur krejt viti. Me pas kritere kishte me qenë më mirë. I vetmi kriter është, shkolla që i ka nën 250 nxënës, drejtori i mban edhe 10 orë mësimi për me bërë fondin e plotë, përndryshe nuk përcaktohet së kur shkolla mundet me mbetur pa drejtor. Gjendja e rëndë në arsim, e kam përshkruar edhe në informatë, dhe gjendja gati së në krejt Kosovën është e njëjtë. Të Bekimi dha një koment me tepër rreth cilësisë, po na kritikon, por nuk e di se ku e ka marrë, me cilat parametra e keni matur cilësinë unë nuk e di. Gjimnazet janë në nivelet e Gjimnazeve në nivelin e Kosovës. Shkollat Profesionale janë në nivelin e shkollave Profesionale të nivelit të Kosovës. Edhe shkolla Teknike edhe të Bujqësia në Ferizaj përqindja e kalueshmërisë është e njëjtë. Një informatë të shkurtër për përkrahjen që kam pasur nga ju, që edhe sot u përkrah ndarja e mjeteve me disa abstenime, unë kam arritur deri sot të shpërndaj mbi 500 mijë euro dhe janë mbuluar të gjitha shkollat, përveç shkollës “Idriz Seferi” dhe Çerdhes së fëmijëve. Pjesa që kaloj sot i mbulon këto dy institucione dhe me iniciativën e kryetarit dhe përkrahjen e juaj kemi dalë nga kjo gjendje dhe nuk i kemi më borgj asnjë arsimtari, ku kemi arritur me ndërprerë procedurën që mos me shkuar me përmbarues privat, ku mundem me thënë së janë kursyer minimumi 1 milion euro. Për gjendjen sot, në asnjë shkollë nuk ka asnjë arsimtar të infektuar me Covid 19. Të gjitha shkollat punojnë sipas skenari “A”, inspektorët e arsimit dhe inspektorët tjerë janë në terren çdo ditë, raportet e inspektorëve janë pa vërejtje, përveç një vërejtje në shkollën e Adnanit. Janë bërë përgatitje nëpër shkolla në këtë vikend sipas Udhëzimeve të MASHT, do të bëhet dezinfektimi 3 D, është kompania e kontraktuar për këtë.

z. Adnan Reka, Faleminderit drejtor, e para me thave se po themi të pavërteta, ti mundësh me thënë çka të duash, me vjen keq nga pozicioni i juaj që po e dëmton autoritetin tënd si i pavarur. 143 laptop, 36 projektor dhe dy kompjuter, me 50 mijë euro, tregomini së ku mundesh me gjetur laptop me 100 € me ato performanca. Mua me vjen keq që ju ose nuk po i kupton sa duhet këto çështje, ose ti si autoritet po e merr të drejtën dhe po iu del në mbrojtje dikujt. Mirë është me qëndruar i pavarur dhe me folur për ato që të takojnë. Këto ka munduar me ia kaluar fjalën tjetër kujt se nuk është punë e jotja. Në Kovaqevc, të shkolla e Adnanit që po thuhet, aty ku është Vetëvendosje duhet me u potencuar, së aty ku është Adnani çdo kund ka telashe, shkolla pikë, dyert nuk mbyllen, tualetet rrjedhin, tabelat bien në klasë pa i prekur, tavolinat, për mua këto defekte të shkollës nuk janë relative.

z. Bekim Koxha, Gjendja në raport është reale. Të cilësia, unë nuk jam i cilësisë, por në bazë të punës, çështjes së ikjes së nxënësve nga shkollat tona, shihet se është diçka në pyetje të cilësia. Të parregullsitë dhe përgatitja e shkollave për fillimin e vitit të ri shkollor, unë kam qenë në shkollën e Doganaj, gjendja është mizërie, muret janë të palyera, ajo shkollë është e vjetër, por nëse mbahet aty mësimi deri sa të përfundon objekti i ri, ajo shkollë nuk i plotëson kriteret për mbajtjen e mësimi, ndërkaq deri sa të shkolla e re mund të mos bëhet edhe 2 apo 3 vjet. Unë mendoj se aty duhet intervenuar në objektin e vjetër për sanimin e defekteve.

z. Agim Mani, Desha një pyetje për DAK, A keni informacion për migrimin e nxënësve për gjatë pandemisë.

Kryesuesi i Kuvendit, Për pyetje e patët rastin në fillim me i ngritur.

z. Zahir Doda, Pyetjes së Agimit i përgjigjem me shkrim, me këto tjerat nuk e kam ndërmend me u marrë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Informatën e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 Lënda: 01Nr. 610/01-26511/20.

4. Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 60/01-504/18 të datës 28.02.2018 -për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A.- Njësia në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Në këtë komision ka qenë anëtare Afërdita Shehi-Horuni, tani ajo nuk është anëtarë e KK, kështu që komisioni duhet të plotësohet me një anëtar nga KK. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë nga me propozime konkrete suke filluar nga subjektet me të mëdha. PDK,

z. Nexhat Loku, Ne subjekti politik i PDK tërhiqem për me pasur anëtar në këtë komision.

Kryesuesi i Kuvendit, LVV është i përfaqësuar në këtë komision, atëherë kalojmë të subjekti politik i LDK.

z. Besnik Salihu, Në GP i LDK, e propozojmë për anëtare të këtij komisioni, Arlinda Rakoci-Raka.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozimin që doli e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01Nr. 60/01-504/18 të datës 28.02.2018-për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A.- Njësia në Kaçanik, ashtu që në vend të Afërdita Shehi Horuni, për anëtare të komisionit caktohet Arlinda Rakoci-Raka / Lënda: 01Nr. 060/01-26898/20.

5. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së KK për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Formimi i komisionit është një procedurë formale për hartimin e Planit të Punës së KK. Përbërja e komisionit do të jetë 5 anëtarë, 4 anëtarë do të jenë nga subjektet politike me të mëdha dhe 1 anëtar nga ekzekutivi i komunës. Kërkoj nga subjektet politike me të mëdha të dalin më nga 1 propozim.

z. Nexhat Loku, Pasi që Kryesuesi i Kuvendit është anëtar i këtij komisioni, ne subjekti politik i PDK nuk do të përfaqësohemi në këtë komision.

z. Ekrem Kyçyku, E propozoj për anëtarë të komisionit, z. Agim Mani.

Nga LDK, u propozua të jetë anëtar i komisionit, Selim Reka,

Nga AAK, u propozua të jetë anëtar i komisionit, Hajredin Luta,

Nga Ekzekutivi i Komunës, u propozua për anëtare të komisionit, Makfire Malsiu.

Subjektet tjera politike të përfaqësuara në KK (NISMA dhe IQ) nuk pranuan të përfaqësohen në këtë komision.

z. Ekrem Kyçyku, Theksoj së Agim Mani tërhiqet nga ky komision, kështu që nga LVV propozojmë për anëtar të komisionit z. Shemsedin Luzha, tanimë anëtarë nga LVV.

Propozimet u shtruan në votim dhe u aprovuan njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së KK për vitin 2021, në përbërje:

- | | | |
|---------------------|----------|----------------------------------|
| 1. Kemal Mërseli, | kryesues | nga KK |
| 2. Shemsedin Luzha, | anëtar | nga KK, |
| 3. Selim Reka, | anëtar | nga KK |
| 4. Hajredin Luta, | anëtar | nga KK |
| 5. Makfire Malsiu, | anëtar | nga Zyra e Kryetarit të Komunës. |
- / Lënda: 01Nr. 60/01-26879/20.

6. Shqyrtimi i Vendimit 01Nr.060/01-18351/20 i datës 12.08.2020-Për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës, sipas Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Financave.

Kryesuesi i Kuvendit, Vendimi për kompensimin e komisioneve na është kthyer nga autoriteti mbikëqyrës së i njëjti bien ndeshë më dispozitat ligjore, edhe pse për mua i paqartë së kërkojnë rrugë tjera, cilat rrugë duhet kërkuar. Unë iu kam drejtuar organeve relevante me një shkresë të cilën e keni edhe ju, me të cilën shkresë e kam kontestuar ligjshmërinë lidhur me këtë vendim. Në respektim të procedurave ligjore, unë e kam proceduar këtë çështje në KK. Sot është në dispozicionin tuaj të vendosni. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Meqë nuk u paraqit kush, atëherë Vendimin e shtroj në votim për shfuqizim; Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ANULIMIN e Vendimit 01Nr.060/01-18351/20 i datës 12.08.2020-Për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të Komunës, në bazë të Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Financave/ Lënda: 01Nr. 60/01-22499/20.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora: 12:15. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës:
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërsel




REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e IX –të (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020, mbajtur me 30 Tetor 2020;

1. Kemal Mërseli..... _____,
2. Hamid Guri..... _____,
3. Ahmet Luma _____,
4. Kadri Krivenjeva,..... _____,
5. Besim Vishi,..... _____,
6. Sali Malsiu..... _____,
7. Lirije Shurdhani..... _____,
8. Pranverë Loku- Zharku..... _____,
9. Lirije Luta..... _____,
10. Vlora Dalloshi..... _____,
11. Nexhat Loku _____,
12. Agim Mani..... _____,
13. Adnan Reka..... _____,
14. Ekrem Kyçyku..... _____,
15. Fatijona Kyçyku..... _____,
16. Kaltrina Tafili _____,
17. Selim Reka..... _____,
18. Besnik Salihu,..... _____,
19. Nazife Krasniqi..... _____,
20. Arlinda Rakoci-Raka..... _____,
21. Shemsedin Luzha..... _____,
22. Albana Troni..... _____,
23. Rabije Sallahi,..... _____,
24. Hajredin Luta..... _____,
25. Hafize Sallahi _____,
26. Bekim Koxha..... _____,
27. Ekrem Raka,..... _____.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

DATË/A:	16.11.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Delegatët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Loku, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigjeje në pyetjen e deputetit: Ekrem Kyqyku lidhur me prerjen e drunjëve(lisave) , te Teqja dhe Qeshmja e Boshnjakëve.

Përgjigjeje në pyetjen e parashtruar nga deputeti i Kuvendit Komunal z.Ekrem Kyqyku, lidhur me prerjen e drunjëve (lisave), te Teqja dhe Qeshmja e Boshnjakëve. Prerjen e drurit të llojit të shkozës në lokacionin, vendi i quajtur "Qeshmja e Boshnjakëve", bazuar në informatat e inspektorit të Pylltarisë z. Feriz Deda, Inspektorit të Ambientit z.Bujar Dullovi dhe Inspektorit të Shërbimeve Publike z.Nebi Murseli, të marrë nga vendi i shiqimit është konstatuar se prerja e drurit të llojit të shkozës te vendi i i quajtur te "Qeshmja e Boshnjakëve" është bërë nga pronari Mendu Halit Piliqi (tani me vendbanim në SHBA), evidentuar në parcelë nr. 1506-6, parcela në fjalë është pronë private. Prerja e drurit të shkozës është prerë pa dijenin tonë d.m.th pa leje për prerje, por që është pronë e tij private, ndërsa druri tjetër i cili është prerë te Teqja, nuk e kemi informacione nga kush është prerë.

Ju informojmë se me datën 16.11.2020, Inspektorët e lartëcekur, kanë dalë në vendin shiqimit dhe kanë kostatuar këtë gjendje: pronari i më lartëcekur ka krasitur një trung të llojit shkozë, i cili nuk është i mbrojtur me vendim nga organet kompetente, (këto trunje nuk janë në listën e monumenteve të mbrojtura natyrore).

Pas daljes në vendin e shiqimit inspektorët kanë ardhur në përfundim se drunjët janë krasitur për shkak të mbrojtjes së objekteve të banimit në afërsi tyre. Në drejtori nuk kemi pasur kërkesë për krasitjen apo prerjen e tyre.

Pasi që drunjët ishin me rrezikshmëri për objektet e banimit, ekzistonte mundësia që nga erërat të forta dhe lagështia e tokës, të rrëshqas ose të thehen dhe kanë paraqitur rrezik për kalimtarë të rastit.

Kësaj shkrese i bashkangjesim fotot e bëra në teren.







Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 17.11.2020

Për: Anëtarët e Kuvendit/ **z. Ekrem Kyçyku,**
znj. Rabije Sallahu,
z. Besim Vishi

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë, **30.10.2020**, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Ekrem Kyçyku

Të shëtitortja rreth lumit Neredime, shtyllat kanë qenë të betonit, shtyllat janë këputur, ndërkaq ka mbetur armatura e cila paraqet rrezik për qytetarë. Kërkoj të merren veprime të nevojshme për heqjen e betonit ku kanë qenë të vendosura shtyllat.

- *Këto shtylla të rrejtit të energjisë elektrike janë dislokuar nga KEDS-i dhe është e vertete që bazamentet e shtyllave të vjetra nuk janë demoluar si duhet. Përkundër që me kohë është kërkuar nga KEDS-i që të bëjë demolimin e tyre, kjo gjë nuk ka ndodhur akoma. Drejtoria e Shërbimeve Publike do të angazhoj kompaninë e kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve dhe në koordinim me KEDS-in do të bëjmë largimin e këtyre bazamenteve të shtyllave elektrike.*

znj. Rabije Sallahu,

Pyetje për DSHPE, Cilat janë emërtimet e rrugëve të reja, a u formua komisioni për këtë çështje, administratorët e fshatrave i kanë dërguar kërkesat e tyre, por ende nuk kanë marrë përgjigje. A është formuar komisioni dhe pse nuk janë bërë ende emërtimet e rrugëve të reja.

- *Komisioni komunal i formuar për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetaret e komunës sonë ka bërë punën e vetë dhe propozimet për emërtime të reja apo ndryshime janë sjellë dhe miratuar në Kuvend komunal me dt. 31.01.2020. Këto emërtime janë në web faqen e komunës.*

Më pas është formuar komisioni komunal për implementimin e Vendimit 01 Nr. 104/02-1699/20 të dt. 31.01.2020 të miratuar nga Kuvendi komunal, i cili poashtu ka finalizuar punën e vet në futjen e të dhënave në databazën e Agjensionit Kadastral të Kosovës dhe në momentin kur të konfirmohen këto të dhëna nga agjensioni, drejtoria e Shërbimeve Publike fillon me vendosjen e tabelave në rrugët e caktuara.


z.BesimVishi,

Sa për informim pasi drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani është prezent në mbledhje, e kam fjalën për ndriçimin publik në f. Dubravë, afër 50 % e dritave janë në defekt Ndoshta ato rregullohen, por mua me ka bërë përshtypje se kjo është bërë dukuri e zakonshme, investimet po bëhen, po shpenzohen mjetet, ndërkaq po ndodhin defektet menjëherë.

- *Operatori ekonomik (punëkryesi) ka periudhën njëvjeçare të garancionit pas përfundimit të punimeve. Me paraqitjen e ndonjë defekti gjatë kësaj periudhe kompania bënë sanimin e tij me kohë. Në rrjetin e ndriçimit publik në rrugën “Beteja e 25 Majit” Dubravë është intervenuar dhe është sanuar defekti edhe pse në të shumtën e rasteve kemi të bëjmë me defekte si rrjedhojë e ndërhyrjes së personave të paautorizuar në kuadrin shpërndarës.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadush Osmani
Drejtore i DSHPE-s